- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë

anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots + On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					

Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;

- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Në bazë të Urdhërit të Kryetarit Nr. 103 datë 03.03.2025, për ngritjen e “Komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e Fondit Limit”, për objektin e prokurimit “Mirëmbajtje dhe ruajtjen e varrezave të vjetra publike, varrezave të reja publike, dhe varrezave të dëshmorëve” më poshtë komisioni ka renditur specifikimet teknike.

I. Specifikime teknike mirëmbajtje dhe ruajtjen e varrezave publike (të reja dhe të vjetra) dhe varrezat e dëshmorëve, ku parashikohet që të kryhen këto shërbime në të 23600 m².

- Punëtor shërbimi (që përfshin, ruajtje turni parë, fshirje të rrugëve/shesheve, pastrimi i mbeturinave, shërbimet kulturale të bimësisë, krasitja e drurëve dekorative, mbjellje drurësh dekorativë.
- Roje turni dytë dhe truni tretë.

1. Mirëmbajtja e varrezave publike të reja dhe të vjetra dhe varrezat e dëshmorëve.

Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave do të kryhet nga punëtori i turnit të parë, dhe konkretisht do të kryhej këto shërbime, fshirje të rrugëve/shesheve, pastrimi i mbeturinave, shërbimet kulturale të bimësisë, krasitja e drurëve, referuar vendodhjes së varrezave që janë në tre vende të ndryshme, për kryerjen e këtij shërbimi nevoiten 3 punëtorë.

2. Ruajtja, mirëmbajtja e varrezave publike të reja dhe të vjetra dhe varrezat e dëshmorëve.

Varrezat do të ruhen 365 ditë të vitit do të jenë 6 (gjashtë) roje, njëri për turnin e dytë dhe tjetri për tretë, referuar vendodhjes së varrezave që janë në tre vende të ndryshme, për kryerjen e këtij shërbimi kërkohen 9 punëtorë, për arsye të vendndodhjes së varrezave në tre vende të ndryshme.

Rregullat për tu zbatuar:

Sipërmarrësi është përgjegjësi kryesor i varrezave publike ai duhet të sigurojë ruajtjen dhe mirëmbajtjen e varrezave. Nuk lejohet të kryej punime në varrezat publike çdo person tjetër fizik e juridik për cdo rast të konstantuar do të njoftohet Bashkia dhe Komisariati i Policisë. Punëtori i shërbimit në varreza do të komunikoj dhe orientojë vizitorët vendas e të huaj në varrezat e të afërmeve të tyre (për raste kur nuk i gjejnë dot varret e të afërmeve të tyre), heqja transporti i mbetjeve të ndryshme që krijohen me karrocë dore ose thes të zinj plastik për në pikën e grumbullimit të mbetjeve. Punëtori i shërbimit në varreza është përgjegjës kryesor për cfarë ndodh në varrezat publike për kohën që kryejnë shërbimin e tyre.

Për asnjë rast nuk do të lejohet që territori i varrezave të mbetet pa ruajtje e mirëmbajtje. Në të gjitha rastet kur evitendohen çrregullime apo pengesa nga faktorë të jashtëm kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë strukturat e Bashkisë, në rast të kundërt për sipërmarrësin do të vendosen penalitete.

Përfaqësuesi i sipërmarrësit duhet të jetë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe të Bashkisë dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 5 orëve nga marrja e njoftimit.

Sipërmarrësi duhet të krijojë/vendos me fondet e veta vend qëndrim të punëtorit të shërbimit dhe rojeve për turnet e dyta dhe treta, në këtë vendqëndrim duhet të ketë edhe regjistrin e varrezave dhe libër ankesash në rastet kur do ketë akesa nga qytetarët.

Përdorimi i uniformave për puntoret që kryejnë shërbimin dhe mirëmbajtjen e varrezave është rigorozisht i detyrueshem dhe në rast moszbatimi aplikohen gjoba për mosplotësimin e këtij detyrimi.

Mjetet dhe Paisjet:

Sipërmarrësi duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale të shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave dhe të gjitha shërbimeve plotësuese të përcaktuara më lartë këto paisje: Rroba pune, vegla pune dhe materiale ndërtimi për riparime të ndryshme.

3. Kositje bari në gjithë territorin e varrezës publike.

Sipërfaqja e varrezave publike është 23600 m², bari që do të kositet për një vit kalendarik është menduar të realizohet 4 (katër) herë.

Rregullat për tu zbatuar:

Sipërmarrësi duhet të mbajë pastër çdo sipërfaqe rrugë e sheshe që ndodhen në zonën e Varrezave publike, bashkia ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë gjendjen e pastërsisë së rrugve dhe të shesheve.

Për raste të veçanta kontraktuesi është i detyruar të fshijë e mirëmbaje rrugët e sheshin në sipërfaqen e varrezave më shumë se një herë pa shpenzime.

Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë procesit të fshirjes të ndotjes që shkakton. Përdorimi i uniformës për puntoret është rigorozisht i detyrueshem dhe do të ndërmeren penalitete për mos plotësimin e tyre.

Mjetet dhe Paisjet:

Punëtorët e mirëmbajtjes së rrugëve e shesheve në sipërfaqen e varrezave duhet të jenë të paisur me fshesë, lopatë, kazëm, karrocë. Veglat e punës të mbahen pastër e të jenë të lyera.

4. Mirëmbajtje dhe mbjellje të reja të drurëve dekorativë.

Duke qënë se varrezat në Çekrez janë varreza të reja kërkohet mbjellja e drurëve dekorativë, të jene të llojit Selvi 10 copë, Mimoza 5 copë dhe Dafinë 5 copë, gjithësej për një vitë kalendarik 20 drurë dekorative, në çmimin e mbjelljes se një druri dekorativ përfshihet vetëm blerja e fidanit, punimet e tjera si hapja e gropave me përmasa 0.8x0.8x0.8 m, mbjellja dhe shërbimet e tjera do të kryhen nga punëtori. Për drurët dekorativë ekzistues do të kryhen të gjitha shërbimet për mirëmbajtjen e tyre.

Rregulla për tu zbatuar:

Për asnjë rast nuk do të lejohen drurë me degë të thyera, ose të thara, të pakrasitur dhe mbeturina të lëna në zonën përreth rrënjës së drurëve, në të gjithë rastet kur evidentohen çrregullime apo pengesa nga faktorë të jashtëm kontraktuesi duhet të njoftojë menjëhere dhe të marrë masa për pastrimin e tyre. Sipërmarrësi duhet të vërë në dispozicion për plotesimin e detyrave kontraktuale, të mirëmbajtjes së drurëve në sipërfaqen e Varrezave dhe të gjithë shërbimeve plotësuese të përcaktuara me lart.

Mjetet dhe Paisjet:

Shkallë dyshe me lartësi 7 m, tub gome, vegla pune si gërrshëre, sharë, motorsharë, spatë etj, për nevojë të mirëmbajtjes së drurëve dhe krasitjes së tyre.

Prerja e drurëve të mëdhenj që rrezikojnë prishjen e varrezave.

Në varrezat e vjerta dhe të dëshmorëve janë 30 pemë si pisha dhe selvi me dm = 50 – 80 cm dhe H= 20 – 30 m të larta, për çdo vit kemi ankesa nga qytetarë për rrezikshmërinë që paraqesin këta drurë, pasi rrezikojnë të rrëzohen nga kushtet atmosferike dhe moshës së vjetër që kanë dhe mund të shkaktojnë një dëm të madh në varrezat, për prerjen e tyre duhen marrë masa për mos dëmtimin e varrezave, për realizimin e këtij procesi kërkohen punëtorë të specializuar dhe paisje të veçanta.

Rregulla për tu zbtuar:

Prerja e drurëve duhet të bëhet me skela, të rrethuara me rrjetë, prerja duhet të bëhet pjesë pjesë duke filluar nga maja e drurit e në zbritje. Për çdo dëm që mund të ketë në qivuret e varrezave siprmarësi mban përgjegjësi deri në rregullimin e tyre me fondet e veta.

Mjetet dhe Paisjet:

Skela inventari, rrjetë mbrojtëse e skelës, morosharrë, shkallë, litar.

KOMISIONI

Kryetar	Anëtar	Anëtar
Xhelil Muça	Ledian Hoxha	Erlinda Çarçiu

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: Mirëmbajtje dhe ruajtjen e varrezave të vjetra publike, varrezave të reja publike dhe varrezave të dëshmorëve për marrëveshjen kuadër me afat 4-vjecar

A	B	C	D	E	F	G	H	I	J
NR	EMËRTIMI	NUMRI I PUNONJESVE	SASIA DITE PUNE/MUAJ	ORE PUNE/DITE (per pune te kryer nga ora 06:00 deri ne 19:00)	ORE PUNE (per pune te kryer nga ora 19:00 deri 22:00)	ORE PUNE (per pune te kryer nga ora 22:00 deri 06:00)	Paga ore pune	SHTESA SIPAS KODIT TE PUNES (%) (per pune te kryer nga ora 19:00 – 22:00)	SHTESA SIPAS KODIT TE PUNES (%) (per pune te kryer nga ora 22:00 deri ne 06:00, festa zyrtare dhe te shtune/diela)
A	PUNETORI MIREMBATJE DHE RUAJTJE E VARREZAVE TE VJETRA E TE REJA DHE VARREZAVE TE DESHMOREVE								
1	Punetore shërbimi	3	22	8			227		0%
2	Roje (Turni I – 104.28 dite/vit – vetem gjate diteve te shtuna/diela)	3	8.69	8			227		25%
3	Roje (Turni II)	3	22	5	3		227	20%	
4	Festat zyrtare (Roje-Turni II – 14 dite/vit)	3	1.17	8			227		25%
5	Dite te shtuna/diela (Roje-Turni II – 104.28 dite/vit)	3	8.69	8			227		25%
6	Roje (Turni III)	3	22			8	227		50%
7	Festat zyrtare (Roje-Turni III – 14 dite/vit)	3	1.17			8	227		50%
8	Dite te shtuna/diela (Roje-Turni III – 104.28 dite/vit)	3	8.69			8	227		50%

Shenim 1: Shërbimi i ruajtjes per turnin I-re eshte llogaritur vetem gjate fundjavave (te shtune e te diele) pasi gjate diteve te javes gjate turnit te I-re punetori I shërbimit do te mbuloje edhe shërbimin e rojes.

Shenim 2: Shërbimi i ruajtjes per turnin e II-te dhe te III-te eshte llogaritur vetem gjate diteve te javes pasi gjate turnit te pare punetori I shërbimit do te mbuloje edhe shërbimin e rojes.

Shenim 3: Vlerat e mesiperme jane bazuar mbi pagen minimale prej 40.000 Leke ne muaj dhe “KODI I PUNËS I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË” (Ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë

13.3.1996; nr. 9125, datë 29.7.2003; nr. 10 053, datë 29.12.2008; nr. 136/2015, datë 5.12.2015; nr. 91/2024, datë 26.7.2024) (i përditësuar)

NR.	Emërtimi	Njësia	Sasia
B	PREVENTIV PRERJE PEMË TË LARTA		
I	Pajisje pune		
1	Skelë inventari	m2	120
2	Veshje me rrjetë mbrojtëse të skelave	m2	90
	Vlera pajisje pune		
II	Punëtori		
1	Prerje pemësh $\varnothing > 76$ cm	op	120

Shënim 1: Prerja e këtyre pemëve do të bëhet me shumë kujdes pasi ato ndodhen midis varreve. Prerja duhet kryer nga maja duke zbritur deri në nivelin zero dhe me copa jo më të mëdha se 10-20 cm në mënyrë që të jetë e mundur që copat të prerë, të lidhen me litar dhe të zbriten me kujdes në tokë. Të gjitha këto operacione do të kryehen në mënyrë manuale pasi është e pa mundur të punohet me mjete në mesin e qivureve. Pemët duhet të rrethohen me skela metalike dhe këto të fundit duhet të jenë të veshura me rrjetë e cila do të pengojë rënien e veglave të punës, degëve të vogla apo ashklave të drurit mbi qivure të cilat do të dëmtoheshin në të kundërt.

3.Preventiv për mbjellje pemësh dekorative

NR.	Emërtimi	Njësia	Sasia
C	PREVENTIV PËR PEMË DEKORATIVE		
1	Selvi	copë	10
2	Mimoza	copë	5
3	Dafinë	copë	5

Afatet e ekzekutimit: 4 vite nga data e nënshkrimit të kontratës

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 10

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore gjatë tre viteve 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për periudhën e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të objektit të prokurimit.

*** Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.**

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilancit për tre vitet 2022, 2023 dhe 2024 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse tatimore, me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me auditimin ligjor të pasqyrave financiare, vetëm kur janë në kushtet e ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, kreu V, neni 41, pika c.

*** Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.**

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.3 Vërtetim të shlyerjes së taksave e tarifave vendore për kestet e maturuara për vitin 2025, në të gjitha adresat ku operatorët ekonomik kanë ushtruar aktivitetin e tyre sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKB-së.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do të kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mësipërm.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të kategorisë III.2B bazuar në pikën 8 dhe 9 të VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare 33 të biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” i ndryshuar, i lëshuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Për operatorët ekonomikë të huaj të bëhet ekuivalentimi/njësimi i licencës profesionale nga vendi i origjinës pranë institucioneve përkatëse. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit

2.3.3 Stafi kryesor punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për keto punime:

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e më poshtëm:

- **Minimuni1 (një) Inxhinier Pyjesh ose ekuivalent (Mjedis,Agromjedis)**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin sipas kërkesave të mëposhtme:

- Stafi teknik i sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për për te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (*e vlefshme*), librezë pune, C.V.
Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar ose ti kene me kontrate kur jane punonjes te jashtem, si më poshtë:

- a) Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre **1 (një) punonjës** i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë certifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”**, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

Nëse OE nuk kanë në stafin e tyre persona përgjegjës me aftësi dhe kualifikimet e duhura lidhur me ceshtjet e sigurise në pune, mund ti sigurojnë këto shërbime me anë marredhenieve kontraktore (të paraqitet kontrata e vlefshme, dhe dokumentacioni përkatës për ushtrimin e profesionit) me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se 10(dhjetë) punonjës nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës perkatëse në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si dhe të përfshirë në listepagesa për periudhën 3 muajt e fundit, me profesionet si më poshtë:

Specialisti

- Specialistë për punime në lartesi

Numri

jo më pak se 2 punonjës

Krahas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatëse në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1.				
2.				
etj.				

* Disponimi i stafit/ punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: Për specialistët e sipercituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten, deshmite/certifikatat ose cdo dokument tjetër që verteton diplomimin/trajnimin/ose kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme.

- Kontrata e punës e vlefshme,
- Dëshmi/ certifikatë kualifikimi të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme/ ose të lartë,
- Secili specialistë i sipercituar sipas profesioneve, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit, nga data e zhvillimit të tenderit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit) :

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Motorrreke	1 copë	Pronësi ose me qera
Korrese Bari me fije	1copë	Pronësi ose me qera
Korrese bari	1copë	Pronësi ose me qera
Skela për punime në lartësi	Jo më pak se 120 m2	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Këpucë pune 10 palë
- Uniforma/Jelek pune 10 cope

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.10 Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- a)** Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas Deklaratës së shoqërisë ofertuese .

b) Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullavete Prokurimit Publik".

2.3.8 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin **certifikatat e cilësisë së punimeve ose ekivalentet e tyre (te azhornuarat)**, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve :

- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 9001:2015 (për sistemin e menaxhimit të cilësisë)**, e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 14001:2015 (për sistemin e menaxhimit të mjedisit)**, e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 45001-2018 (për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)**, ose certifikatën ekuivalente, e vlefshme,

Ne rastin e bashkimit të perkohshëm të shoqërive secili operator duhet të paraqesë certifikatat e mesipërme, në varesi të punimeve që do të marri përsipër konform marrëveshjes.
